

**KONFERENCA E IV-TË KOMBËTARE**  
**“PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT / PËR NJË LIGJ MË TË MIRË”**

**Prezantim i Sistemit Elektronik të Kërkesave për Informacion**

**Z. Andi DOBRUSHI**, *Drejtor ekzekutiv*  
*Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë*

I nderuar Komisioner Z. Dervishi,

Të nderuar përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore,

Të nderuar përfaqësues të trupës diplomatike dhe aktorëve ndërkombëtar,

Të nderuar aktorë të shoqërisë civile,

Të nderuar kolegë,

Siç tashmë është bërë traditë, vit pas viti, Fondacioni në bashkëpunim me zyrën e Komisionerit vlerëson të nevojshme **analizimin, në medime të tilla** me përfaqësues të institucioneve publike dhe shoqërinë civile, **të progresit dhe sfidave më të cilat përballet zbatimi në praktikë i dy ligjeve** të rëndësishme për transparencën qeveritare dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, siç është Ligji “Për të drejtën e informimit” dhe ai “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

**Informacioni është vlerësuar me të drejtë si oksigjeni i një shoqërie demokratike**, ndërsa hapja dhe transparenca e institucioneve shtetërore janë konsideruar si përbërësit kyç për të siguruar llogaridhënien e institucioneve shtetërore si dhe besimin e qytetarëve në shoqëri, të cilat janë të nevojshme për funksionimin e demokracisë dhe ekonomisë të tregut.

**Transparenca** e veprimtarisë së organeve publike dhe **pjesëmarrja qytetarëve** në politikëbërje, janë **garanci për mirëqeverisje, politika publike cilësore dhe organe shtetërore të përgjegjshme** përpara qytetarëve.

Megjithë standardet e larta që parashikojnë këto dy ligje, pas afro katër vitesh pas miratimit, **në një vlerësim përgjithësues konstatojmë se zbatimi i tyre në praktikë shënon ende mangësi dhe probleme.**

Vlen të theksohet **një progres relativisht më i lartë i respektimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” krahasuar me atë të konsultimit publik.**

Raportet ndërkombëtare, por dhe monitorimet e aktorëve vendas, përfshirë këtu dhe vetë monitorimet e kryera nga Fondacioni dhe partnerët e tij në këto vite, **konstatojnë progres** sidomos në lidhje me:

- **Emërimin e koordinatorëve të së drejtës së informimit në nivel qendror dhe vendor**, pavarësisht se ata ende nuk gëzojnë statusin që ligji i atribuon;
- **kërkesat rutinë për informacion publik tashmë trajtohen në një kohë më të shkurtër nga institucionet shtetërore**, pavarësisht se transparencja proaktive e institucioneve lë për të dëshiruar dhe programet e transparencës ende nuk ofrojnë të gjithë informacionin publik të kërkuar nga ligji. Aksesit në kontratat e prokurimit, ato koncesionare apo auditimet është ende shumë i vështirë për t’u arritur.

Gjatë këtyre 4 viteve, vihet re një **ritje e besimit të shoqërisë civile dhe opinionit publik në tërësi ndaj zyrës së Komisionerit**, si rezultat i numrit gjithmonë e në rritje të ankesave dhe zgjidhjes në një masë të konsiderueshme të tyre përmes ndërmjetësimit të kësaj Zyre me institucionet shtetërore. Gjithashtu, vlen të theksohet **jurisprudenca** që institucioni i Komisionerit ka krijuar përmes vendimmarrjes së tij, **gjithmonë në favor të hapjes së informacionit duke ruajtur balancën e shëndetshme ndërmjet ofrimit të informacionit që ka interes për opinion publik dhe mbrojtjes së të dhënave personale apo garancive të procesit të rregullt ligjor**. Të tilla janë vendimet për publikimin e kontratave të ndryshme koncesionare, apo të dhënave statistikore në lidhje me vlerësimin e gjyqtarëve apo prokurorëve që janë nënshtruar procesit të vetting-ut. E megjithatë, **edhe në këtë drejtim, ka një kufizim ligjor**, vendimet e Komisionerit nuk janë të detyrueshme për autoritetet publike. Për këtë dhe arsyet e përmendura dhe nga Besniku në

fjalën e tij vlerësohet e nevojshme amendimi i ligjit “Për të drejtën e informimit”.

**Qëllimi i takimit të sotëm është mundësimi i një procesi konsultues të hapur e gjithëpërfshirës ndërmjet institucioneve, në cilësinë e subjekteve përgjegjëse për respektimin e ligjit, dhe shoqërisë civile, në cilësinë e promovuesit kryesor, e cila ka kontribuar në mënyrë të qënësishme në progresin aktual të këtyre ligjeve, përmes investimit të mekanizmave të duhur ligjor.**

Për sa i takon ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin”, ai zbatohet në nivele relativisht të ulëta, çka e minon transparencën e proceseve vendimmarrëse të projektakteve, duke mos i mundësuar palëve të interesuara të jenë pjesë e një procesi konsultimi efektiv dhe cilësor. Probleme më të mëdha lidhen kryesisht me:

- **mosfunktionimin e regjistrimit elektronik** për njoftimin dhe konsultimin publik,
- **mosaktivitetin e koordinatorëve përkatës** në të gjitha institucionet shtetërore në nivel qendror e vendor,
- **aplikimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik mbi baza selektive dhe formale,**
- **mospublikimin e programeve vjetore të procesit të vendimmarrjes,** dhe mangësi në hartimin dhe publikimin e **raportit vjetor për transparencën;**
- **mosrespektimin e kërkesave** që dikton ligji **për kryerjen efektive dhe cilësore të konsultimit** përsa i takon procedurave, njoftimeve të grupeve të interesit dhe afateve të konsultimit, si dhe
- **mungesën e një mekanizmi shtetërore përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe raportimit për ecurinë e tij.**

Krahas këtij dimensioni kritik por konstruktiv, Fondacioni ka dhe një **dimension tjetër: atë të mbështetjes së institucioneve** shtetërore në drejtim të rritjes së **transparencës dhe lehtësimit të aksesit** në informacion, e cila për hir të së vërtetës kërkon **ndryshime rrënjësore në praktikën e punës së institucioneve** dhe në **mentalitetin e mbyllur të administratës publike.**

Për këtë qëllim, në bashkëpunim me zyrën e Komisionerit është krijuar **Sistemi Elektronik i Kërkesave për Informacion**, i cili tashmë është bërë i detyrueshëm për të gjithë institucionet publike përmes VKM nr. 145, datë 13.3.2018 për Krijimin e Rregjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve “Për të drejtën e informimit”.

**Sistemi elektronik i kërkesave për informacion** është i pari sistem i këtij lloji i cili përmes teknologjisë së informacionit, i mundëson qytetarëve të adresojnë online kërkesat e tyre për informacion publik përmes portalit [www.pyetshtetin.al](http://www.pyetshtetin.al).

***Cilat janë benefitet kryesore të këtij sistemi elektronik për qytetarët, aktorët e shoqërisë civile apo dhe për gazetarët?***

Ky sistem do të ndihmojë kryesisht në:

1. **Lehtësimin e aksesit** të çdo subjekti të interesuar për njohjen dhe marrjen informacionit me karakter publik në një kohë të shkurtër dhe pa kosto;
2. **Rritjen e transparencës dhe efektivitetit të monitorimit të institucioneve** publike për garantimin e të drejtës për informim;
3. **Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarit**, duke i ofruar mundësinë reale për të kërkuar informacionin publik online.
4. **Mundësinë e gjurmimit të kërkesës për informacion** në të gjitha etapat përmes së cilës ajo kalon si dhe mundësinë për të alertuar kërkuesin për të marrë masa të nevojshme, si psh, për të ofruar sqarime të ndryshme në rast se kërkesa është e paqartë apo për t’u ankuar në ato raste kur afatet për kthimin e përgjigjes përfundojnë;
5. **Shmangien e burokracive shtetërore** si dhe mundësimin e një kanali të drejtëpërdrejtë komunikimi me personin përgjegjës brenda institucioneve publike për çështjet e transparencës, siç është koordinatori.

Me të drejtë lind pyetja, po për institucionet shtetërore ky sistem elektronik lehtëson punën apo është një barrë shtesë në morinë e detyrimeve që ata kanë?

**Besojmë se në terma afatshkurtër, ky sistem elektronik do të sjellë përfitime të drejtpërdrejta në disa aspekte.** Kështu, për shembull:

1. Përmes këtij sistemi do të mundësohet **krijimi i regjistrit kombëtar të digitalizuar të kërkesave për informacion publik** dhe integrimi në një sistem të vetëm të të gjithë institucioneve publike;
2. **Evidentimin e saktë të kërkesave për informacion në shkallë kombëtare** për të gjithë institucionet publike (gjë e cila sot është e pamundur për t'u identifikuar) duke kontribuar në **vlerësimin real dhe objektiv të nivelit të transparencës së institucioneve** përkundrejt qytetarëve;
6. **Ngritja e një sistemi të automatizuar të proceseve të punës për koordinatorët** e të drejtës për informim sipas kërkesave ligjore. Ky sistem nga njëra anë do të **rrisë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarit** në marrjen e informacionit publik, duke ndërtuar procese pune të dokumentuara e lehtësisht të auditueshme por në të njëjtën kohë, **evidenton ngarkesën reale dhe performancën e punës të koordinatorëve** të së drejtës së informimit.
7. Krijimi i këtij regjistri të kërkesave dhe përgjigjeve për informacion mundëson draftimin e analizave konkrete për orientimin e politikave shtetërore për nxitjen e transparencës proaktive.
8. Ky sistem ndër të tjera **promovon parimin e qeverisjes së hapur me anë të procesve inovative inteligjente**, gjë e cila është bërë trend i zhvillimeve të kohës ku ne jetojmë dhe që vendi ynë nuk mund të mos përfitojë prej tyre.

Ky sistem aktualisht është instaluar dhe po funksionon **në 27 institucione:**

- **përkatësisht në 12 institucione në pushtetin qendror** (në Kryeministri dhe në 11 ministritë e linjës),
- **në 7 institucione në nivel vendor** (bashkinë Durrës, Fier, Elbasan, Lezhe, Tiranë, Korçë dhe Shkodër) si dhe
- në **8 institucione të tjera**, të tilla si Bankën e Shqipërisë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Agjencinë e Prokurimit Publik, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Kontrollin e lartë të Shtetit, vetë zyrën e Komisionerit, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore si dhe Policinë e Shtetit.

**Kriteri për përzgjedhjen e institucioneve** ishte numri më i lartë i kërkesave dhe ankesave për informacion si dhe objektivi i veprimtarisë së institucioneve në lidhje me trajtimin e çështjeve me interes të lartë publik.

Ndërsa **ankimet në rrugë elektronike** tek Komisioneri në rast refuzimi apo kufizimi të kërkesave për informacion **mund të bëhen ndaj çdo institucioni publik** përmes portalit pyetshtetin.al.

Ne gjykojmë që përfituesit kryesor të këtij sistemi elektronik do të jenë të gjithë:

- Qytetarët
- Bizneset
- Organizatat joqeveritare
- Media
- Vetë institucionet publike
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit si dhe
- Të gjithë subjektet e tjera që parashikohen në kuadrin ligjor për informimin publik.

Për këtë qëllim, ju ftojmë të gjithëve ta shfrytëzojmë sa më shumë këtë sistem për të lehtësuar aksesin në informacion dhe nxitur transparencën e institucioneve shtetërore.